



Erzen Shkolli. Foto: Atthe Mulla

Komunikatë për Media
22 Nëntor 2023



Autostrada Biennale

Erzen Shkolli emërohet kurator i edicionit të pestë të Autostrada Biennale, 2025

Autostrada Biennale në Prizren, ka kënaqësinë të njoftojë se Erzen Shkolli është përzgjedhur kurator i edicionit të 5-të, i cili do të mbahet nga 5 korrik deri më 5 tetor 2025.

Autostrada Biennale u themelua në vitin 2014 me mision për të përdorur artin bashkëkohor si një mjet për të forcuar komunitetin dhe për të nxitur kreativitetin me vizionin e një të ardhmeje më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Me këtë rast, bashkëthemeluesit e Autostrada Biennale Leutrim Fishekqiu, Vatra Abrashi dhe Barış Karamuço, deklaruan: "E mirëpresim emërimin e Erzen Shkolllit kurator të edicionit të 5-të të Autostrada Biennale. Ekspertiza e gjerë e Shkolllit dhe bashkëpunimi i tij me institucione vendore e ndërkombëtare dhe artistë të shumtë nga rajoni dhe bota përshtaten në mënyrë të përkryer me etikën e bienales. Duke qenë kuratori i parë kosovar i bienales, bashkëpunimi ynë me Erzenin synon ta përmbush qëllimin tonë për përfshirjen (shndërrimin) e artit në një forcë të fuqishme për ndryshime pozitive dhe mirëqenie në komunitet."

Erzen Shkololli (1976) është artist dhe kurator. Aktualisht, ai është kurator i përgjithshëm i galerisë Cukarna në Ljublanë. Shkololli suksesshëm ka udhëhequr disa institucione të artit, duke përfshirë Galerinë Kombëtare të Arteve të Shqipërisë (2018–2022) dhe Galerinë Kombëtare të Arteve të Kosovës (2011–2015). Nën drejtimin e tij, të dy institucionet kanë kaluar nëpër transformime të rëndësishme. Krahas roleve të tij institucionale, Shkololli ka shërbyer si komisioner i pavijonit inaugurues të Kosovës në Bienalen e Venecias (2013) dhe ka kuruar ekspozita ndërkombëtare, duke përfshirë Edi Hila: Piktori i transformimit (2018), një projekt bashkëpunimi ndërmjet Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë, Muzeut të Artit Modern në Varshavë dhe Koleksionit Kontakt në Vjenë; Ne jetojmë mbi një yll (2016), edicioni i dytë i Trienes Hannah Ryggen, i ekspozuar në Ørland dhe Nordenfjeldske Kunstindustrimuseum, Trondheim; Bota nuk do të dëgjojë (2007) në Punëtorinë e Artit Lazareti, Dubrovnik; Historia filloi të luante me jetën time (2007) në Digital Art Lab (DAL), Holon, Izrael; dhe Rishfaqja (2004) në Muzeun e Kosovës, Prishtinë. Shkololli shërbeu si këshilltar kuratorial i documenta 14. Ai u nderua me bursën DAAD Artists-in-Berlin (2008/2009) dhe Premio Michetti nga Fondazione Michetti (2001). Në vitin 2013, ai bashkëthemeloi Institutin e Artit Bashkëkohor EXIT në Pejë, Kosovë. Veprat artistike të Shkolollit janë ekspozuar në muze si Stedelijk Museum në Amsterdam, Centre Pompidou në Paris, Tate Modern në Londër dhe MUMOK në Vjenë.

“Jam i nderuar me këtë emërim prestigjioz. Si kosovari i parë i ftuar për të kuruar Autostrada Biennale në Prizren, ndjej një respekt të thellë dhe i gëzohem mundësisë së bashkëpunimit me një nga platformat më të rëndësishme të artit bashkëkohor në Kosovë dhe në rajon. Për mua, kjo është një sfidë dhe një përgjegjësi e thellë, të cilën po e pranoj me nentuziazëm dhe ambicie. Pres me padurim të bashkëpunoj ngushtë me ekipin e jashtëzakonshëm të bienales për të sjellë artistë në Kosovë dhe për t'i jetësuar projektet e tyre. Shpreh mirënjohjen time të përzemërt për themeluesit e bienales, Leutrim Fishekqiu, Vatra Abrashi dhe Bariş Karamuço, për këtë mundësi të veçantë,” tha Shkololli.

Si i vetmi institucion i artit bashkëkohor në Prizren, Autostrada Biennale përqëndrohet në dy aspekte - ekspozitën ndërkombëtare të artit bashkëkohor që mbahet çdo dy vjet, që nga viti 2017 dhe Autostradën Hangar, hapësirën për edukim, krijim dhe ekspozim në ish-bazën ushtarake të KFOR-it gjerman (tani, Parku i Inovacionit dhe Trajnimit). Me këtë të fundit, ne kemi zgjeruar platformën tonë, duke e konsideruar procesin e krijimit të artit si formë të qëndrueshme të mësuarit dhe shkëmbimit, që u përgjigjet nevojave të komuniteteve artistike. Autostrada Biennale gëzon mbështetjen e një game të gjerë institucionesh, artistësh e artdashësish. Kjo platformë ka zhvilluar partneritete të suksesshme me organizata dhe institucione të ndryshme, duke përfshirë Fondacionin Allianz, Ministrinë e Kulturës në Kosovë, Komunën e Prizrenit, Komunën e Prishtinës, Fondacionin për Iniciativa Artistike, Ambasadën Amerikane në Prishtinë, ITP Prizren dhe shumë të tjerë.

Kuratorët e mëparshëm të Autostrada Biennale:

2017: Manray Hsu

2019: Giacinto Di Pietrantonio

2021 & 2023: Joanna Warsza dhe Övül Ö. Durmuşoğlu

Kontakti për Media:

Njomza Abrashi

njomza@autostradabiennale.org

+38349415800

Adresa: Uke Bytyqi, pn, Autostrada Hangar, ITP Prizren, 20000 / Kosovë

www.autostradabiennale.org

info@autostradabiennale.org